

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë në AKMC

Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave

Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve

Procedurat për të bërë kërkesë dhe ankesë, janë të parashikuara sipas Ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit/ KREU III NJOHJA ME INFORMACIONIN PUBLIK/ Neni 11: Kërkesa për informim", gjithashtu, Neni 12 - "Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim", ku në pikën 2 të këtij Neni citohet "Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin"

Procedura për kërkesë-ankesë bëhet nëpërmjet shkresës zyrtare (ankesë), dhe (sipas rastit procedohet me kthim përgjigje me shkresë, postë elektronike ose pritje të qytetarëve).

Mekanizmat kërkesë-përgjigje funksionojnë nëpërmjet Zyrës së Bashkëqeverisjes, në Kryeministri, nga Koordinatori për informim në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe nëpërmjet adresës zyrtare të institucionit dhe koordinorit për informim të AKMC.